29.3 Menaxheri i Projektit do të lëshojë te autoriteti kontraktues ose te përfaqësuesi i tij i autorizuar, dhe te Kontraktuesi, deklaraten e llogarisë përfundimtare që paraqet shumen përfundimtare për të cilën duhet paguar Kontraktuesi në bazë të kontratës. Autoriteti kontraktues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar dhe Kontraktuesi duhet të nënshkruajnë deklaraten e llogarisë përfundimtare, si një njohje e vlerës së plotë dhe përfundimtar të punës së realizuar sipas kontratës dhe menjëherë do të dorëzojë një kopje të nënshkruar të Menaxherin e Projektit.

Neni 30 Shkaqet për kompensim

30.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa tjera për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFEKTET

Neni 31 Parimet e përgjithshme

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara ne shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët te cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe te jete lëshuar, ose konsiderohet te jete lëshuar, **një certifikatë e pranimit të përkohshëm**.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, te jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe te cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdojë vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjojë një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimi të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një **certifikatë të pranimi përfundimtar**, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimi do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimi nga Menaxheri i Projektet dhe te jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimi dhe të cilat kanë mbetur të parealizuar në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimi. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Shkelja e kontratës dhe shkëputja

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- (a) Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- (b) Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonës;
- (c) Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- (d) Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- (e) Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;

(f) Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e Punëve për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur cilado nga palët kontraktuese njofton Menaxherin e Projektit për shkelje të kontratës për arsye të tjera nga ato të renditura më lart nën 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë a është shkelja thelbësore apo jo.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesit do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 “Force Madhore” siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t’i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t’i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t’i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një çertifikatë mbi vlerën e punës së përfunduar dhe materialet e porositura me më pak se përqindja e cila kërkohej nga vlera e punëve të përfunduara, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhësimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve.

Neni 40

Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41

Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri I Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo qe palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

30.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

616-25-2338-5-1-1/C1783

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është 10 % për kohëzgjatjen e periudhës prej 37 muajve
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhivë është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhivë është i pakufizuar e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhivë është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 3

		dite pas nënshkrimit të planit të menaxhimit.
	12.2	Periodha për Programin e azhurnuar është 3 ditë kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 3 dite pas nënshkrimit të kontratës.
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 36 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit në baza ditore! Libri ndërtimor dhe Ditari ndërtimor do të mbahen në vendndërtim gjatë tërë kohës së ekzekutimit të punimeve nga fillimi deri në përfundimin e punimeve dhe deri në lëshimin e Certifikatës së Pranimit të Përkohshëm të Punëve (dhe të lëshohet Certifikata e Përdorimit). Udhëheqësi i vendndërtimit duhet të jetë prezent në vendndërtim me orarë të plotë të punës nga dita e parë e fillimit të punëve deri në përfundimin e tyre gjatë tërë kohës së implementimit të kontratës për organizimin dhe mbikëqyrjen e punimeve në vendndërtim, konform dokumentacionit ndërtimor dhe rregulloreve dhe standardeve teknike të ndërtimit. Inxhinierët përgjegjës i fazës së ndërtimit duhet të jenë prezent në vendndërtim me orarë të plotë gjatë tërë kohës sa ekzekutohen punime nga fusha përkatëse e tyre inxhinierike për të kontrolluar,verifikuar,sasinë dhe cilësinë e materialeve dhe punimeve dhe për të verifikuar zbatimin e normave dhe standardeve të ndërtimit për fazën e tij.
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është: do të përcaktohet pas nënshkrimit të kontratës
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: N/A
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10% i vlerës së kontratës. Kjo shume do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit dhe do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit të deklaratës së llogaritë përfundimtare të referuar në Nenin 29 të KPK. Kontraktuesi mund të zëvendësojë paratë të mbajtura me garancion bankar “me kërkesë” ose kompania e sigurimi Shuma e parave të mbajtura do të mbahet gjatë tërë periudhës së defekteve 1 vit.

Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 3 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 1 vit
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Komerciale -Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.



FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: 616-25-2338-5-1-1

Titulli i kontratës: 178 Investimi dhe rregullimi i hapësirave publike faza III-të

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.
2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

1 178 Investimi dhe rregullimi i hapësirave publike faza III-të

3. Çmimi total i tenderit është:

50,342.90 EUR

Dhe në fjalë [shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro]

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: 120 nga data finale për dorëzim të tenderëve.

5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës

6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet] si partner në konsorcium të udhëhequr nga [shëno emrin e udhëheqësit]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.

7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK

8. Theksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj

INVESTIMI DHE RREGULLIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE FAZA E III-të					
Nr.	PËRSHKRIMI I PUNËVE	Njësia	Sasia	Çmimi me TVSH	Shuma me TVSH
A.					A: Totali I (80 % e përkëje të vlerësimit)
1	Furnizimi, transporti dhe montimi i shportës Model CBTR-FT-BK ose e ngjashme me karakteristika minimale sipas detalit dhe hapave Figura 8.1: A≥95cm, B≥70cm, C≥55cm, D≥60cm, E≥70cm, F≥20cm. Shporta me kapak shtesë nga materiali 100% nga çeliku rrezistent nga korezioni me profile të plota (jo gyp) me të gjitha konstruksionet e salduara të përbërë nga shufrat e plota vertikale≥0.9x2.5cm ku numri i tyre duhet të jetë prej 40 deri 45 copë. Shufra lidhëse lart duhet të jetë me prerje tërthore rrethore me diametër ≥15mm. Përvesh shufrës së epërme duhet të ketë edhe 2 shufra tjera lidhëse në pjesën qëndrore dhe poshtë në formë shiriti me trashësi ≥0.6x5cm.Kapaciteti i shportës së mbrendshme duhet të jetë ≥135litra nga materiali poli-plastik i ngurtë. Vërejtje:Duhet të punohet bazamenti, me bulona për montim dhe duhet të përmbajë të gjitha elementet shtesë të pa specifikuar në këtë përshkrim deri në funksionalizimi të plotë të shportës.Ngjyra e shportës e pjekur zgjidhet nga organi mbikqyrës.	copë	1	525	525.00 €
2	Furnizimi, transporti dhe montimi i shtyllës kubike nga betoni-sipas dimensioneve minimale: Dimensionet gjenerale L: 380 mm B: 380 mm H: 400 mm Pesha: 130 kg Materiali nga betoni i kombinuar me mermer ose graniti (terrazzo), me sipërfaqe të lëmuar dhe stampuar.Stampimi i llogos (hyjnesha në fron me përshkrim Komuna e Prishtinës) nga materiali INOX.Përzlerja e polirit zgjidhet nga organi mbikqyrës(e bardhë, kaft, hirit, e zezë etj).Me mbulesë Varnish-gloss spas standardit EN 1504-2). Rrezistenca ndaj korezloni sipas standardeve (EN 13198:2003, EN ISO 15630-1- 2004, EN10025:2004) Klasa e betonit C60/75 sipas standardit EN 12390-3:2019. Hidroizolimi sipas standardit EN206:2021. Rrezistenca ndaj ngricave sipas standardit EN206:2021.Figura 9	copë	1	535	535.00 €
3	Furnizimi, transporti dhe montimi i fontanave për pije të ujit, nga materiali i granitit. Në pozicion të parashihet edhe gypi për furnizimin e të dyja fontanave me ujë të pijshëm, qeshme me siguresen për lëshuarjen dhe ndaljen e ujit dhe të gjitha elementeve përbërëse që duhet të ketë kjo fontan në mënyrë që të jetë funksionale dhe stabile. Të punohet sipas vizatimit.Të gjitha punët duhet të përfundojnë në pajtim me organi mbikqyrës. Figura 10	copë	1	2455	2,455.00 €
4	Furnizimi, transporti dhe montimi i ulëses-sipas dimensioneve minimale: L: 3300 mm B: 500 mm H: 450 mm Pesha: 1000 kg Materiali nga betoni i kombinuar me mermer ose graniti (terrazzo), me sipërfaqe të lëmuar.Stampimi i llogos (hyjnesha në fron me përshkrim Komuna e Prishtinës) nga materiali INOX.Përzlerja e polirit zgjidhet nga organi mbikqyrës(e bardhë, kaft, hirit, e zezë etj).Me mbulesë Varnish-gloss spas standardit EN 1504-2). Derratat e ulëses (7 copa) duhet të jenë sipas dimensioneve: L: 1900 mm B: 60 mm H: 40 mm. Dru i fortë i certifikuar nga FSC - bambu dhe me veshje të sipërme me ujë (llak) (ISO 9001) Rrezistenca ndaj korezloni sipas standardeve (EN 13198:2003, EN ISO 15630-1- 2004, EN10025:2004) Klasa e betonit C60/75 sipas standardit EN 12390-3:2019. Hidroizolimi sipas standardit EN206:2013+A1:2016. Rrezistenca ndaj ngricave sipas standardit EN206:2013+A1:2016.Figura 11	copë	1	1355	1,355.00 €
5	Furnizimi, transporti dhe montimi i ulëses-sipas dimensioneve minimale: L: 3300 mm B: 610 mm H: 840 mm Pesha: 935 kg Materiali nga betoni i kombinuar me mermer ose graniti (terrazzo), me sipërfaqe të stampuar. Stampimi i llogos (hyjnesha në fron me përshkrim Komuna e Prishtinës) nga materiali INOX.Përzlerja e polirit zgjidhet nga organi mbikqyrës(e bardhë, kaft, hirit, e zezë etj).Me mbulesë Varnish-gloss spas standardit EN 1504-2). Derratat e ulëses (12 copa) duhet të jenë sipas dimensioneve: L: 1900 mm B: 60 mm H: 40 mm. Dru i fortë i certifikuar nga FSC - bambu dhe me veshje të sipërme me ujë (llak) (ISO 9001) Rrezistenca ndaj korezloni sipas standardeve (EN 13198:2003, EN ISO 15630-1- 2004, EN10025:2004) Klasa e betonit C60/75 sipas standardit EN 12390-3:2019. Hidroizolimi sipas standardit EN206:2021 . Rrezistenca ndaj ngricave sipas standardit EN206:2021.Figura 12	copë	1	3233	3,233.00 €
6	Furnizimi, transporti dhe montimi i ulëses-sipas dimensioneve minimale: Dimensionet gjenerale :Ø: 2000 mm H: 430 mm Pesha: 140 kg Këmbet e Betonit (4 copa): D1: 200 mm D2: 100 mm H: 350 mm Materiali nga betoni i kombinuar me mermer ose graniti (terrazzo), me sipërfaqe të stampuar. Stampimi i llogos (hyjnesha në fron me përshkrim Komuna e Prishtinës) nga materiali INOX.Përzlerja e polirit zgjidhet nga organi mbikqyrës(e bardhë, kaft, hirit, e zezë etj).Me mbulesë Varnish-gloss spas standardit EN 1504-2). Derratat e ulëses (40 copa) duhet të jenë sipas dimensioneve: L: 460 mm B1: 146 mm B2: 75 mm H: 43 mm. Dru i butë brendi i certifikuar nga FSC dhe shtresat e sipërme të pigmentuara me ujë (impregnator dhe llak) (ISO 9001). Ngjyra e drurit zgjidhet nga organi mbikqyrës (palsandër, arrë, lisi, mahagoni, plishe etj.) Rrezistenca ndaj korezloni sipas standardeve (EN 13198:2003, EN ISO 15630-1- 2004, EN10025:2004). Elementi metalik: 6 3-6 mm (me formë rrethore dhe dimensione specifike), çelik S 235 JR, EN 10025, Hibrid ester-epoksid (ISO14001:2015), poliestër pluhur, i ngurtë, elektrostatik Klasa e betonit C60/75 sipas standardit EN 12390-3:2019. Hidroizolimi sipas standardit EN206:2021 . Rrezistenca ndaj ngricave sipas standardit EN206:2021.Figura 13	copë	1	1830	1,830.00 €
7	Furnizimi, transporti dhe montimi i ulëses-sipas dimensioneve minimale: Dimensionet gjenerale :Ø: 3000 mm H: 400 mm Pesha: 195 kg Këmbet e Betonit (4 copa): B1: 260 mm B2: 154 mm H: 320 mm Materiali nga betoni i kombinuar me mermer ose graniti (terrazzo), me sipërfaqe të stampuar. Stampimi i llogos (hyjnesha në fron me përshkrim Komuna e Prishtinës) nga materiali INOX.Përzlerja e polirit zgjidhet nga organi mbikqyrës(e bardhë, kaft, hirit, e zezë etj).Me mbulesë Varnish-gloss spas standardit EN 1504-2). Derratat e ulëses (26 copa) duhet të jenë sipas dimensioneve: L: 460 mm B1: 146 mm B2: 75 mm H: 43 mm. Dru i butë brendi i certifikuar nga FSC dhe shtresat e sipërme të pigmentuara me ujë (impregnator dhe llak) (ISO 9001). Ngjyra e drurit zgjidhet nga organi mbikqyrës (palsandër, arrë, lisi, mahagoni, plishe etj.) Elementi metalik: 6 3-6 mm (me formë rrethore dhe dimensione specifike), çelik S 235 JR, EN 10025, Hibrid ester-epoksid (ISO14001:2015), poliestër pluhur, i ngurtë, elektrostatik Rrezistenca ndaj korezloni sipas standardeve (EN 13198:2003, EN ISO 15630-1- 2004, EN10025:2004) Klasa e betonit C60/75 sipas standardit EN 12390-3:2019. Hidroizolimi sipas standardit EN206:2021 . Rrezistenca ndaj ngricave sipas standardit EN206:2021.Figura 14	copë	1	1300	1,300.00 €

8	Furnizimi, transporti dhe montimi i uleses e ndertuar nga guri i granitit. Forma organike apo natyrale me nje finalizim "mat" apo "shkelqim". Pjesa e sipërme nga kaliepi i lëmuar "mat" ose "shkelqim". Veshja dhe ndertimi granitit speciale ndaj degradimit dhe i cilesise se larte (UNI EN ISO 14201; UNI EN ISO 14001:2015;UNI EN ISO 45001:2018; UNI EN ISO 9001:2015 ; PEFC ST 2002:2002; PEFC ST 2001:2002; EM 1090-1:2009+A1:2011). Ngjyra percaktohet nga organi mbikqyres. Dimensionet e uleses duhet te jene L:830mm; W:845mm; H:840mm;; pesha 660kg. Figura 15	copë	1	1955	1,955.00 €
9	Furnizimi, transporti dhe montimi i tavolines se lakuar per te lujatur futboll. Materiali nga betoni i klases se larte HTC apo densitetit te larte te betonit 6400 kg/m3 (UNI EN ISO 14201; UNI EN ISO 14001:2015;UNI EN ISO 45001:2018; UNI EN ISO 9001:2015 ; PEFC ST 2002:2002; PEFC ST 2001:2002; EM 1090-1:2009+A1:2011). E pajisur me 4 mbeshtetese tubash celiku te lyer, fiksuar mekanikisht ne trupin e betonit dhe nje tub celiku per ndarese te fushes, i fiksuar ne tavolinen nga betoni me ane te pllakave te celikut. Mbeshtetese jane te pajisura me kembe qe rregullohen mbi toke, ose fiksohen per te u betonuar ne toke. Ngjyra percaktohet nga organi mbikqyres. Dimensionet e tavolines se futbollit duhet te jene : L:3000mm; W:1500mm; H:900mm; pesha 928kg.Figura 16	copë	1	3000	3,000.00 €
10	Furnizimi, transporti dhe montimi i Vazos "Luna" e bere gure te çmuar nga graniti i rindertuar. E pajisur me nje kulluese te integruar te tejmbushjes se vazos qe siguron shkallen e lageshtise ne toke, duke mundesuar qe i gjithë uji te shperndahet ne vazo. (UNI EN ISO 14201; UNI EN ISO 14001:2015;UNI EN ISO 45001:2018; UNI EN ISO 9001:2015 ; PEFC ST 2002:2002; PEFC ST 2001:2002; EM 1090-1:2009+A1:2011). Dimensionet e vazos duhet te jene: Ø830mm; H:520mm; pesha 360kg. Sasia e mbushjes me dhe humus deri ne 87.7l.Figura 17	copë	1	1850	1,850.00 €
11	Furnizimi, transporti dhe montimi i shportes per mbeturina, nga gure te granitit te rindertuar, i perbere nga nje element monolit me nje profil trapezoid. E pajisur ne njeran ane me nje bllokues per deren hapese dhe nga ana tjeter me nje panel, te dyja te punuara me flete celiku te lyera. Shporta ka nje ene te brendshme prej pllakes se celikut. (UNI EN ISO 14201; UNI EN ISO 14001:2015;UNI EN ISO 45001:2018; UNI EN ISO 9001:2015 ; PEFC ST 2002:2002; PEFC ST 2001:2002; EM 1090-1:2009+A1:2011). Dimensionet e shportes duhet te jene: L:582mm; W:500mm; H:1000mm; pesha 230 kg. Sasia e mbushjes deri ne 120l.Figura 18	copë	1	2555	2,555.00 €
12	Furnizimi, transporti dhe montimi i fontanës së ujit -sipas dimensioneve minimale: L: 1100 mm B: 430 mm H: 900 mm Pesha: 300 kg Materiali nga betoni i kombinuar me mermer ose graniti (terrazzo), me sipërfaqe të lëmuar.Stampimi i llogos (hyjnesha në fron me përshkrim Komuna e Prishtinës) nga materiali INOX.Përzlerja e polirit zgjidhet nga organi mbikqyrës (e bardhë, kaft, hirit, e zezë etj).Me mbulesë Varnish-gloss spas standardit EN 1504-2). Rezistenca ndaj korezioni sipas standardeve (EN 13198:2003, EN ISO 15630-1- 2004, EN10025:2004) Klasa e betonit C60/75 sipas standardit EN 12390-3:2019. Hidroizolimi sipas standardit EN206:2021. Rezistenca ndaj ngricave sipas standardit EN206:2021.Figura 19	copë	1	2200	2,200.00 €
13	Furnizimi, transporti dhe montimi i vazos se rrumbullakete C me ndenjes rrethore, e bere nga guri granit i rikonstruktuar, me prerje forme gjysme sferike dhe brazda terthore dhe te pajisura me nje vrime qendrore per mbijelljen e drunjeve apo bimeve. (UNI EN ISO 14201; UNI EN ISO 14001:2015;UNI EN ISO 45001:2018; UNI EN ISO 9001:2015 ; PEFC ST 2002:2002; PEFC ST 2001:2002; EM 1090-1:2009+A1:2011). Ngjyra e granitit perzgjedhet nga organi mbikqyres. Dimensionet e vazos rrethore duhet te jene: Ø2050mm dhe Ø1015mm; H:480mm; pesha 1039kg. Sasia e mbushjes me dhe humus deri ne 389l. Figura 20	copë	1	5450	5,450.00 €
14	Furnizimi, transporti dhe montimi i shportave set (3 copë-3 ngjyrëshe) -sipas dimensioneve minimale: Dimensionet gjenerale Ø: 400 mm H: 850 mm V:3 x 30 L Pesha: 3 x 100 kg Pjesa nga betoni Ø: 400 mm H: 640 mm Ø: 50 mm Kapaku metalik: Ø: 400 mm Ø: 3 mm Pjesa e mbrendshme V:30 L Ø: 1 mm -elektroegjallvanzuar. Materiali nga betoni i kombinuar me mermer ose graniti (terrazzo), me sipërfaqe të stampuar.Stampimi i llogos (hyjnesha në fron me përshkrim Komuna e Prishtinës) nga materiali INOX.Përzlerja e polirit zgjidhet nga organi mbikqyrës (e bardhë, kaft, hirit, e zezë etj).Me mbulesë Varnish-gloss spas standardit EN 1504-2). Rezistenca ndaj korezioni sipas standardeve (EN 13198:2003, EN ISO 15630-1- 2004, EN10025:2004) Klasa e betonit C60/75 sipas standardit EN 12390-3:2019. Hidroizolimi sipas standardit EN206:2021. Rezistenca ndaj ngricave sipas standardit EN206:2021.Figura 21	set	1	1850	1,850.00 €
15	Furnizimi, transporti dhe montimi i tavolinës-sipas dimensioneve minimale: Dimensionet gjenerale:L: 1900 mm B: 1480 mm H: 740 mm Pesha:420kg Dimensionet e tabelës L: 1900 mm B: 680 mm H: 60 mm Këmbët me dimensione L: 1450 mm B: 120 mm H: 680 mm Materiali nga betoni i kombinuar me mermer ose graniti (terrazzo), me sipërfaqe të lëmuar.Stampimi i llogos (hyjnesha në fron me përshkrim Komuna e Prishtinës) nga materiali INOX.Përzlerja e polirit zgjidhet nga organi mbikqyrës (e bardhë, kaft, hirit, e zezë etj).Me mbulesë Varnish-gloss spas standardit EN 1504-2). Rezistenca ndaj korezioni sipas standardeve (EN 13198:2003, EN ISO 15630-1- 2004, EN10025:2004) Klasa e betonit C60/75 sipas standardit EN 12390-3:2019. Hidroizolimi sipas standardit EN206:2013+A1:2016/NA:2017. Rezistenca ndaj ngricave sipas standardit EN206:2013+A1:2016/NA:2017.Figura 23	copë	1	3000	3,000.00 €
16	Furnizimi, transporti dhe montimi i tavolinës-sipas dimensioneve minimale: Dimensionet gjenerale:L: 1900 mm B: 1480 mm H: 740 mm Pesha:450kg Dimensionet e tabelës L: 1900 mm B: 680 mm H: 60 mm Këmbët me dimensione L: 1450 mm B: 120 mm H: 680 mm Materiali nga betoni i kombinuar me mermer ose graniti (terrazzo), me sipërfaqe të lëmuar.Stampimi i llogos (hyjnesha në fron me përshkrim Komuna e Prishtinës) nga materiali INOX.Përzlerja e polirit zgjidhet nga organi mbikqyrës (e bardhë, kaft, hirit, e zezë etj).Me mbulesë Varnish-gloss spas standardit EN 1504-2). Rezistenca ndaj korezioni sipas standardeve (EN 13198:2003, EN ISO 15630-1- 2004, EN10025:2004) Klasa e betonit C60/75 sipas standardit EN 12390-3:2019. Hidroizolimi sipas standardit EN206:2013+A1:2016/NA:2017. Rezistenca ndaj ngricave sipas standardit EN206:2013+A1:2016/NA:2017.Figura 24	copë	1	2150	2,150.00 €
17	Furnizimi, transporti dhe montimi i tabelës së pingpongut-sipas dimensioneve minimale: Dimensionet gjenerale:L: 2740 mm; B: 1525 mm; H: 760 mm Pesha: 1000 kg e akorduar me standardin EN 14468-1:2015 Dimensionet e tabelës L: 2740 mm B: 1525 mm H: 60 mm e akorduar me standardin EN 14468-1:2015 Këmbët me dimensione L: 1225 B: 200 mm H: 700 mm e akorduar me standardin EN 14468-1:2015 Materiali nga betoni i kombinuar me mermer ose graniti (terrazzo), me sipërfaqe të lëmuar.Stampimi i llogos (hyjnesha në fron me përshkrim Komuna e Prishtinës) nga materiali INOX.Përzlerja e polirit zgjidhet nga organi mbikqyrës (e bardhë, kaft, hirit, e zezë etj).Me mbulesë Varnish-gloss spas standardit EN 1504-2). Rezistenca ndaj korezioni sipas standardeve (EN 13198:2003, EN ISO 15630-1- 2004, EN10025:2004) Klasa e betonit C60/75 sipas standardit EN 12390-3:2019. Hidroizolimi sipas standardit EN206:2013+A1:2016/NA:2017. Rezistenca ndaj ngricave sipas standardit EN206:2013+A1:2016/NA:2017.Duhet të dorëzohen 4 reketë dhe 4 topa për një tavolinë.Figura 25	copë	1	4850	4,850.00 €

18	Furnizimi, transporti dhe montimi i shahut të jashtëm-sipas dimensioneve minimale: Dimensionet gjenerale: L: 5000 mm B: 5000 mm H: 50 mm Peshë: 3000 kg Pllaka e betonit: L: 500 mm B: 500 mm H: 50 mm Peshë: 30 kg Materiali nga betoni i kombinuar me mermer ose graniti (terrazzo), me sipërfaqe të lëmuar. Stampimi i llogos (hyjnesha në fron me përshkrim Komuna e Prishtinës) nga materiali INOX. Përzlerja e polirit zgjidhet nga organi mbikqyrës (e bardhë, kaft, hirit, e zezë etj). Me mbulesë Varnish-gloss sipas standardit EN 1504-2). Rezistenca ndaj korezioni sipas standardeve (EN 13198:2003, EN ISO 15630-1- 2004, EN10025:2004) Klasa e betonit C60/75 sipas standardit EN 12390-3:2019. Hidroizolimi sipas standardit EN206:2021. Rezistenca ndaj ngricave sipas standardit EN206:2021. Duke përfshirë edhe figurat e shahut. Figura 26	copë	1	3500	3,500.00 €
19	Furnizimi, transporti dhe montimi i vaznës nga betoni-sipas dimensioneve minimale: Dimensionet L: 150 cm B: 45cm H: 40 mm Peshë: 260 kg Materiali nga betoni i kombinuar me mermer ose graniti (terrazzo), me sipërfaqe të lëmuar dhe stampuar. Stampimi i llogos (hyjnesha në fron me përshkrim Komuna e Prishtinës) nga materiali INOX. Përzlerja e polirit zgjidhet nga organi mbikqyrës (e bardhë, kaft, hirit, e zezë etj). Me mbulesë Varnish-gloss sipas standardit EN 1504-2). Rezistenca ndaj korezioni sipas standardeve (EN 13198:2003, EN ISO 15630-1- 2004, EN10025:2004) Klasa e betonit C60/75 sipas standardit EN 12390-3:2009. Hidroizolimi sipas standardit EN206:2021. Rezistenca ndaj ngricave sipas standardit EN206:2021. Figura 29	copë	1	850	850.00 €
